



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2584 /2023
Data: 22.03.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.02.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Xhevdet Bushi** (Shef i Zyrës së Prokurimit), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesi i OSBS-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.
4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020 , 2021 dhe 2022 në vitin 2023.
5. Plani i menaxhimit të mbeturinave.
6. Raporti financiar për vitin 2022 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
7. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- jemi munduar me i paraqitur në detaje të gjitha aktivitetet e kryetarit dhe drejtorive dhe zyreve përkatëse që i raportojnë kryetarit të komunës. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- nga marrja e mandatit në dhjetorë të vitit 2021 e që ka kaluar një vit e tre muaj nuk kemi asnjë përmirësim sa i përket çështjes së ujit përveç ish punimeve që kanë mbetur nga ish pushteti të cilat kanë qenë të pa përfunduara por edhe sot është e njëjta situatë pavarësisht zotimit të juaj që çështja e ujit do të jetë prioritet sa më të shpejtë, mirëpo po flasim për kalimin e afatit që nga muaji maj –qershor që janë potencuar në kuvend. Viti 2022 ka kaluar por ujë nuk kemi. Sa i përket punimeve të ujit kërkoj sqarim nga drejtoria përgjegjëse dhe nga kryetari i komunës në mënyrë më të detajuar për punët të cilat janë bërë . A keni ndërmarr diçka sa i përket çështjes së ambientit në këtë drejtim sepse të gjithë e dimë ndotjen të cilën e kemi në komunën tonë nga “Sharrceci” dhe mbetjet e azbest çimentos. Nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë 60 raste të cilat janë të regjistruara me kancer dhe prej tyre 44 janë të diagnostifikuar me kancer të mushkërive. Si qëndron gjendja pas vitit 2018 . Gjatë matjeve për çështje të ambientit a keni ndonjë raport si është gjendja aktualisht dhe apo monitorohet nga komuna dhe inspektorati përkatës . Sa inspektime janë bërë sa i përket ndotjes . Faqe 58 të shërbimit sociale në vitin 2022 ishin tri raste me forma të rënda të punës dhe kërkoj sqarim se çfarë konkretisht keni ndërmarr për këtë çështje.

Sevdi Dernjani thekson:- sa i përket çështjes së ujit për vitin 2022 komuna është marr me çështje konkrete për çështjen e ujit. Në muajin qershor dhe korrik në fshatin Gorancë është investuar në shumë prej 40 000 € për çështjen e ujit të pijes dhe jemi duke u mundura me bërë në kuadër të Bifurkacionit . Në Han të Elezit janë duke u bërë investime, jemi drejt finalizimit të një procesi që nga viti 2010 dhe duhet ta shohim se çka po na sjellë ky projekt që është një jetë e tërë i kushtuar , duhet të shihet se sa do të ketë prurje të ujit , sa do të jetë funksional . Pa u finalizuar ky projekt nuk mundemi me marr hapa konkret tjetër për orientimin sa i përket investimeve më konkrete të ndonjë burimi të ujit.

Sherif Berisha thekson:- pushteti i juaj ka potencuar se keni ekspert të lëmive të ujit dhe deri më tani ende ndonjë hulumtim nuk e keni bërë në këtë drejtim por po e pritni projekti në vazhde të cilin nuk po mundem me kuptuar se pse nuk po përfundon ky projekt. Për çështjen e ujit në fshatin Gorancë jam informuar edhe pse nuk jam i kënaqur por nuk duhet të presim ndonjë shkaktarë dhe pastaj me intervenuar. Për shkak të mungesës së ujit pushtet i kaluar ka rënë dhe ju po vazhdoni me të njëjtin avaz dhe keni proklamuar ekspertë.

Sevdi Dernjani thekson:- ne duhet të presim që me u finalizuar ky projekt dhe në këtë projekt kemi qenë bashkë investitorë por nuk jemi të kontraktuar me punë kryesin i cili është tu i ekzekutuar punimet në vend ngjarje. Komuna me një far forme është mbikëqyrës të punimeve që janë tu ekzekutuar në atë projekt dhe të gjitha vendimet të cilat janë marr në këtë projekt janë vendime të qeverive të kaluara dhe ne jemi mbikëqyrës të këtij projekti , jemi bashkë financues por të gjitha mjetet që komuna i ka investuar në këtë projekt janë dedikuar CDI-së Zvicerane dhe ajo i ka zhvilluar procedurat dhe është kontraktuar kompania “Teuta” për me i kryer punimet . Komuna është mbikëqyrëse e punimeve dhe jemi tu insistuar me të gjitha kapacitete tona me finalizuar këtë projekt . Sa i përket hulumtimeve për çështje të ujit nuk mundemi me paraqitur në raport diçka që nuk kemi konkrete por vazhdimisht jemi në bisedime me donatorë vendorë dhe jashtë vendit për zgjidhjen e këtij problemi. Në momentin që do të kemi diçka konkrete do të ju njoftojmë.

Nexhmedin Daci thekson:- në muajin prill apo në maj e kemi raportin mjedisorë por mund ta diskutojmë edhe tash këtë çështje por nuk kemi të dhëna prej stacionit për monitorimin e ajrit . Në përgjithësi ne e dimë gjendjen në Han të Elezit që ndotje ka dhe ajo vjen kryesisht prej “Sharrcemit”, mbetjeve të azbestit, prej qarkullimit të madh të kamionëve , veturave të dobëta . Inspektori i mjedisit vazhdimisht del në teren dhe në momentin që hasin shqyrtojnë gjoba . Më gjerësisht do të ju njoftojë kur do ta kemi si pikë të rendit të punës.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket rasteve me kancer do të marr një statistikë të saktë për shkak se trajtimin e marrin edhe nëpër qendra private . Për çështjen e rasteve të fëmijëve me punë të rënda në momentin që i identifikojmë qendra për punës sociale jepë këshilla familjare dhe individuale dhe nëse keqtrajtohet përsëri fëmija rastin e përcjellim për në gjykatë .

Zaim Bela thekson:- te drejtoria e administratës faqe 22 është shënuar se janë zgjedhur bashkësitë lokale por duhet të jetë se janë zgjedhur këshillat e fshatrave . Po në të njëjtën faqe shënon se po transmetohen lajv seancat e kuvendit të komunës por nuk po i shohim se a janë tu transmetuar . Në faqe 22 shënon se janë paraqitur me shifra lëndët e proceduara dhe është mirë të shihen lëndët e proceduar dhe me bërë një krahasim me vitin paraprakë. Te drejtoria e arsimit faqe 32 shënon kemi filluar me shujta e nxënësve në shkollën fillore nga klasa e parë deri në klasën e pestë kërkoj sqarim se pse është ndalur. Drejtoria e urbanizmit realizimi i projekteve nga gjithsejtë pesëmbëdhjetë janë përfunduar vetëm pesë projekte . Është shënuar për çështjen e mjedisit se janë bërë disa inspektime por nuk kemi ndonjë shënim sa i përket gjobave . Te drejtoria e bujqësisë unë mendojë se është raport nga viti i kaluar por këtu e shohë se ka paraparë prerje për furnizim të qytetarëve me dru djegëse në disa zona dhe ka planifikuar njëmijë kubikë dru dhe sa do të mundemi me i realizuar . Në raport shënon se janë formuar komisionet për regjistrimin e dëmeve dhe disa komisione të tjera por nuk pashë ndonjë shifër . Konfiskim të masës drusore prej tetëdhjetë e katër kubik dhe numri fletë paraqitjeve ishte rritur dhe kur rritet numri i fletë paraqitjeve nuk është mirë për shkak se prehet. Nuk është ndonjë shifër se sa është dëm i regjistruar , sa është i arsyetuar dhe sa është pa arsyetuar.

Natyra Kalisi thekson:- nuk përkon ndonjë gabim nëse thuhet bashkësi lokale apo këshilla të fshatrave por esenca është se janë themeluar katër këshilla të fshatrave . Për transmetim e seancave lajve mundmi me thënë se jemi lajv në jutube , ndërsa sa i përket pjesës së televizionit nuk kemi mundësi për shkaqe buxhetore. Sa i përket numrit të lëndëve janë 10537 lëndë në vitin 2022 ndërsa në vitin 2021 janë 9931 lëndë.

Hisni Luri thekson:- shujtat i kemi ekzekutuar për aq mjete sa kemi pasur që ka qenë një vendim i z. Hekuarn Murati por shuma ka qenë shumë e vogël . I kemi ekzekutuar për katër muaj e dy javë sa ka zgjatur procesi mësor dhe në momentin që lëshon mjete financiare Ministria ne do ta vazhdojmë .

Abduraman Bushi thekson:- vitin e kaluar na është kërkuar që me pasur të planifikuar çështjen e masës drusore dhe rojet e kemi identifikuar terenin dhe parcela më të përafërta nuk kemi mundur me gjet. Në momentin që nënshkruhet nga Ministri inspektorati do të i përcakton. Ju e dini që janë tre roje dhe formohen tre komisione për regjistrim të terenit . Dëmet e arsyeshme i kam paraqitur ata të cilat nuk kanë qenë të mbulushme për këtë vit. Numri i fletë paraqitjeve është rritur për shkak se e kemi shtuar kontrollin dhe punëtorët kanë qenë më shumë në teren.

Zaim Bela thekson:- nëse janë ata kubikë që i keni paraqitur punëtorëve duhet tu jepni lëvdata por realiteti në teren siç e di unë është shumë kontradiktorë me shifrat të cilat i keni paraqitur .

Abduraman Bushi thekson:- sa i përket dëmeve se a janë të besueshme apo të pa besueshme ata i bënë komisioni dhe ato shifra komisioni mi ka dorëzuar dhe unë i besoj komisionit .

Nexhmedin Daci thekson:- projektet kapitale të vitit 2022 janë projekte të cilat i kemi miratuar në vitin 2021 nga kuvendi i më parshëm dhe ekzekutivi i më parshëm. Janë pesëmbëdhjetë projekte të cilat kanë qenë për vitin 2022 dhe në të gjitha këto projekte kemi punuar për me i realizuar , mirëpo janë disa projekte që nuk kemi pasur kapacitete për me i kryer p.sh e kemi shtratin e lumit Lepenc që komuna i ka ndarë pesë mijë euro dhe gjatë gjithë vitit 2022 kemi kontaktuar me bankën botërore të cilët e kanë miratuar këtë projekt dhe kjo varet prej Qeverisë se a do ta miraton apo jo . Në listë të projekteve e kemi pasur rrugën Gorancë – Krivenik që ishin të ndara pesë mijë euro dhe atë që ka mundur komuna me bërë e ka hartuar projektin detal dhe vlera e këtij projekti është mbi një milion euro . Komuna ka parashtruar kërkesë në ministrinë përkatëse për me realizuar këtë projekt dhe nënkryetari ka biseduar me zëvendës ministrin dhe kanë dhënë premtime që do të na ndihmojnë në realizimin e këtij projekti . Për projektin për kanalet atmosferike kemi konkurruar me komunën e Tearcës në Ipa fonde dhe në javën e kaluar na kanë njoftuar se ky projekt e ka kaluar fazën e parë . Projekt i qendrës kulturore ka përfunduar , te parku “Isa Berisha” përmbi 90 % e punimeve . Projekt i rrugicave ka përfunduar si projekt. Projekt i kanalizimeve ka përfunduar . Projekt i rrugës te Ramukt do të fillon në Pranverë.

Refet Kalisi thekson:- për afërsisht kur bëhet finalizimi i projektit të Ujit. Te drejtoria e urbanizmit plotësisht pajtohem me projektet që jeni duke punuar por asnjë projekt nuk e keni përfunduar të gjitha i keni lënë në gjysmë . Ulëset të cilat janë vendosur te parku “Isa Berisha” nuk e di ku e keni marr atë model për shkak se e keni pasur modelin e ulëseve që i kemi pasur çdo herë dhe janë shumë më të mira.

Sevdi Dernjani thekson:- ne dimë që projekti i realizimit të ujit në fshatin Dimcë e dimë të gjithë që ka filluar në vitin 2010 dhe nuk kemi ndonjë datë se kur ka me u realizuar , ashtu qysh potencova edhe më herët që projekti nuk është në kompetencën tonë të proceduarve të prokurimit për shkak se po të ishin procedurat e prokurimit përmes komunës do të kishim dhënë ndonjë datë se kur mund të përfundon ky projekt. Me gjithë kapacitete drejtorisë së shërbimeve publike është duke u punuar me u finalizuar projekti.

Nexhmedin Daci thekson:- çështja e ulëseve është çështja e shijeve unë nuk i kam përzgjedhur por janë përzgjedhur nga projektuesit.

Sherif Berisha thekson:- është ka punohet te parku “Isa Berisha” por është mirë që të kontrollohet puna në mënyrë që mos të japim mjete financiare për projektet që bëhen për një muaj apo dy muaj për shkak se nëse i shikoni shtyllat elektrike dhe lojërat e fëmijëve janë dëmtuar. U potencuar përfundimi i shtëpisë së kulturës e di që në projekt ka qenë zerimi profesional dhe në manifestimet që mbahen nuk është akustika që kërkohet dhe është mirë që kur të bëhet pranimi teknik duhet të ketë verifikim të duhur.

Hyriete Isufi thekson:- te drejtoria për bujqësi është paraparë paramasa dhe parallogaritja e kanalit për ujitje Lloka dhe në cilën pjesë është paraparë ky kanal.

Abduraman Bushi thekson:- vitin e kaluar e kemi bërë paramasën dhe parallogaritë dhe kjo parashihet me u bërë te pronat e fshatit Seqishtës në vendin e quajtur Lloka.

Resul Suma thekson:- për çështje të ujit kanë shkuar shumë vite dhe janë shpenzuar shumë mjete financiare për investimin në fabrikën e ujit në Dimcë dhe çka nëse bëhet fabrika dhe përsëri nuk ka ujë për Hanin e Elezit . A ka hulumtuar komuna ndonjë burim tjetër.

Sevdi Dernjani thekson:- nuk mundemi me dhënë ndonjë detal sa i përket ndonjë hulumtimi të ndonjë burimi të ujit për Hanin e Elezit por jemi të fokusuar drejt përfundimit të këtij projekti i cili është trembëdhjetë vjeçar dhe jemi në pritjen e rezultatit të këtij projekti . Ne jemi tu hulumtuar edhe ndonjë plan tjerë për çështje të ujit por nuk mundemi me thënë diçka konkrete sa i përket këtij hulumtimi dhe studimi. Ju kam dërguar shkresa tri apo katër Ministrive dhe kam pas takim edhe me sekretarin e Ministrisë së Planifikimit hapësinorë por edhe me zëvendës ministrin e ekonomisë por edhe me një takim ku ka qenë Kryeministri dhe e kam hapë çështjen e ujit karshi institucioneve qendrore .

Sherif Berisha thekson:- ftoj z.Resul Suma së bashku me stafin e tij për protestë para komunës për çështjen e ujit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë diskutim mund të parashtroni.

Hanumshahe Dibrani thekson:- është një gabim teknik duhet të shtohet edhe një dyshë që të bëhet 2022.

Sherif Berisha thekson:- përgëzojë për punën dhe për hapësirën që na i ke dhënë dhe unë mund të themë vetëm fjalë të mira.

Refet Kalisi thekson:- jemi të kënaqur me hapësirën që na i ke dhënë dhe gjatë viti 2022 kemi kaluar mirë dhe besoj që edhe në vitin 2023 do të kalojmë mirë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020 , 2021 dhe 2022 në vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- të hyrat e bartura nga viti 2020 dhe 2021 në vitin 2022 kanë qenë në shumën prej 72,737.76€, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 62,485.72 €, ndërsa kanë mbetur për bartje edhe 10,252.04 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2022 kanë qenë në shumë prej 358,827.93 €, prej tyre janë të shpenzuara 243,822.54 €, mbetja nga të hyrat e vitit 2022 është 115,005.39 € kurse për bartje në vitin 2023 janë gjithsej 125,257.43 €. Këto mjete sipas pikës dy (në shumë prej 125,257.43 €, i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 8,723.53 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 1,033.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 115,500.90 €.

Zaim Bela thekson:- sa është diferenca për shkak se shuma ka ndryshuar dhe kërkoj sqarim për shkak se më shumë mjete kanë qenë për me u kthyer.

Kryesuesi thekson:- ndryshimet janë bërë me rekomandim të auditorit dhe ne e kemi paraparë me ndryshuar me kohë e jo pasi të miratohet .

Lindita Ballazhi thekson:- shumat kanë ndryshuar por në imell e kemi sqaruar se është një plotësim ndryshim i kësaj kërkesë për bartje të mjeteve . Në konsultim me Ministrinë e Financave dhe me auditorët ne kemi përfshirë në këtë formë. Më herët ka qenë 147 000 €, ndërsa tash është në shumë prej 125 257.43 €, ndërsa kategoritë të cilat bëjmë kërkesë për bartje të mjeteve janë të njëjta vetëm se janë zvogëluar shumat në disa projekte.

Sherif Berisha thekson:- të shpenzimet kapitale të drejtorisë së Arsimit ishin ndarë 26000 € dhe kërkoj sqarim se çfarë investime janë planifikuar. Te drejtorisë së shëndetësisë shuma prej 1000 € për rregullim të infrastrukturës dhe të një aneksi në QKMF mendoj se kjo shumë është e vogël.

Lindita Ballazhi thekson:- aneksi ka qenë të shkresa e parë dhe tash është hequr krejtësisht.

Hisni Luri thekson:- janë planifikuar për të shkollat e mesme “Dardania” për rregullimin e banjovë, rregullimin e kulmit për shkak se është me defekt që shumë vite , rregullimin e kabinetit të informatikës . Te shkollat fillore “Ilaç Thaçi” me rregulluar pjesën e korridoreve kurse në shkollën e fshatit Gorancë dhe Paldenicë do të rregullohen shkallët emergjente.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË PASHPENZUARA NGA VITI 2020, 2021 DHE 2022 NË VITIN 2023

5. Plani i menaxhimit të mbeturinave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- plani i ka kaluar të gjitha procedurat, është shqyrtuar në Komitet për Politikë e Financa, në Kuvend të Komunës dhe në debat publik. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Hyriete Isufi thekson:- në plan shënon edhe ndarja e mbeturinave dhe riciklimi a parashihet në këtë vit me filluar dhe si do të funksionon.

Sherif Berisha thekson:- debateve publike me ju kushtuar rëndësi më shumë se debati publik nuk është për zyrtarë komunal dhe secila drejtori që organizon debat publik është mirë me ndryshuar këtë qasje.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket ndarjes së mbeturinave në këtë vit nuk e kemi në të ardhme por e kemi paraparë në plan dhe shpresojmë që në të ardhme që me realizuar. Informimi për debat publik është bërë me kohë dhe e kemi shpall në veb faqe të komunës.

Refet Kalisi thekson:- në material janë të cekuar shumë mirë por plani edhe koston e ka të madhe e jam skeptik se është vështirë me u realizuar .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

6. Raporti financiar për vitin 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam për me shtuar.

Zaim Bela thekson:- nëse nuk ju bëhet ndonjë zbritje dhe nëse nuk bëhet në mënyrë obligative me u bërë legalizimi i objekteve është problem për shkak se nëse e ke një shtëpi banimi 200 m² kostoja e legalizimit është 400 € .

Nexhmedin Daci thekson:-sa i përket çmimit nuk ka me pasur ndryshime me Ligj të Ri për ndrysh këtyre shpenzimeve nuk munden me ju ikur për shkak se nëse sot aplikon për leje për një shtëpi të re kushton shumë më shumë se për me legalizuar. Për ndërtimet e kategorisë së parë nuk kërkohet projekt por kërkohet matja gjeodezike

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- a ju ka përfunduar kontrata tre infermierëve të cilët kanë qenë të angazhuar prej komunës , a do të merren të njëjtit apo do të shpallet konkurs i ri. Është bërë pranimi teknik i Shtëpisë së Kulturës, a hapet biblioteka në këtë vit dhe a është menduar për me i bërë rafta për fëmijët të shkolla fillore nga klasa e parë deri në klasën e pestë për shkak të peshave të rënda të çantave. Treg ditorë nuk ka për shkak se nuk është i kompletuar dhe si komunë na vyhet një treg ditorë.

Erbilin Meliqi thekson:- të rregullohet ndriçimi publik në Lagjen Meliq për shkak se disa drita nuk funksionojnë

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- kontrata që caktohet për tre muaj në momentin që skadon duhet të shpallet procedurë e re për shkak se janë pranuar përmes prokurimit dhe po planifikojmë me shpallur procedurë përsëri. Jemi në kontakte edhe me disa shoqata të huaja dhe deri sa të marrim një përgjigje prej tyre nuk mundemi me i shpenzuar mjetet edhe me kontrata në vepër.

Hisni Luri thekson:- biblioteka është hapur dhe kush do që donë me shkuar me lexuar mundet me shkuar. Për raftat të shkolla kemi tentuar me i bërë donacion dhe është mirë që me reduktuar orarin në mënyrë që me ja lehtësuar çantat.

Majlinda Kaloshi thekson:- pjesa e tregut është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme, mirëpo komuna nuk ka hapësira të mjaftueshme në vendet ku janë lehtësisht të qasshme për qytetarët që me pasur qasje direkte. Në të ardhmen do ta diskutojmë këtë çështje.

Arsim Dernjani thekson:- për çështje të ndriçimit publik është nënshkruar kontrata dhe do të fillojnë për me rregulluar ndriçimin publik.

Zaim Bela thekson:- është diskutuar shumë për çështje ujit të Hanit të Elezit dhe do të ishte mirë që me biseduar me komunë e Kaçanikut që me u shtuar kapacitete e ujit të Gllloboçicës.

Ajnure Thaçi thekson:- drejtorja për shëndetësi a ka menduar me bërë ndonjë kontroll nëpër shkolla. Te parku "Isa Berisha" sipas informatave që i kemi po bëhet dëmtimi i koshave të mbeturinave , a është menduar me vendosë ndonjë kamerë që mos me pasur dëme të tjera.

Xhevahir Dernjani thekson:- ka mungesë të infuzioneve në QKMF dhe Ministria e Shëndetësisë në këtë drejtim nuk ka lëvizur . Komuna për këtë çështje ka premtuar që do të mundohet brenda mundësive që ka me mundësit buxhetore. Projektet për fshatin Paldenicë u shpaleshën por kemi disa rrugica që duhet të shtrohen me kupëza betoni . Ka ankesa nga disa banorë të fshatit Paldenicë për shkak se ju kanë vjedhur shtëpitë dhe është mirë këtë çështje me diskutuar edhe në KKSBB.

Kryesuesi thekson:- vjedhje ka pasur edhe më herët por jo në kësi mase dhe me të vërtetë është një shqetësim sepse bëhet tri apo katër vjedhje brenda natës e nuk është shejë e mirë . Është mirë që çështja e kamerave të shikohet për shkak se nuk po funksionojnë dhe ka pasur raste më herët kur kanë punuar kamerat janë zbuluar por ndoshta kamerat nuk janë duke i shikuar . Ky shqetësim është seriozë sepse mbahen mbledhje të KKSBB-së dhe nuk është puna vetëm me kaluar dhe nuk është mirë që në këtë kohë me u friguar për këtë çështje.

Emine Luri thekson:- a ka ndonjë pacientë që është aktiv me covid-19 në komunën tonë . A keni ndërmarr ndonjë vendim për qentë endacak për shkak se është rrezik për qytetarët.

Sevdi Dernjani thekson:- sa i përket vjedhjeve të cilat kanë ndodhë përgjegjës është stacioni policorë dhe në KKSB kemi kërkuar që policia me pasur kontrolle më të shpeshta. Në fillim të mandatit nga stacioni policorë kemi pranuar kërkesë për çështje të kamerave që duhet të hiqen prej zyrës së Kryetarit të Komunës për shkak se ka qenë në monitorim qyteti prej zyrës së Kryetarit. Nga komandanti stacionit policorë kemi pranuar një kërkesë për me i vendosë kamerat dhe kërkesën e kemi dërguar në Ministri të Punëve të Brendshme për rregullimin e kamerave dhe nuk kemi marr përgjigje. Komuna ka filluar procedurën për rregullimin e këtyre kamerave.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- vizitën nëpër shkolla e kemi të planifikuar por plani shkon sipas qendrës së mjekësisë familjare dhe zakonisht në muajin mars janë të planifikuar këto vizita sistematike. Sa i përket listës esenciale këtë problem e kanë të gjitha komunat e Kosovës . Javën e kaluar takim kemi pasur me Ministrin e Shëndetësisë dhe pikërisht kjo temë është diskutuar . Sa i përket situatës me covid qytetarët nuk po kanë interes që të testohen dhe ndonjë rekomandim nuk kemi marr nga institucionet përgjegjëse dhe masat nga Qeveria janë siç kanë qenë vitin e kaluar.

Sherif Berisha thekson:-pse nuk ftohet deputeti i Lëvizjes Vetë Vendosi në ditët shënuese të komunës. Nga drejtorja për shëndetësi kemi pranuar shkresën me shkrimë dhe sipas analizave të Vetë Vendosi mund të themi që ka shkelje për çështjen e stomatologut dhe pjesës përcjellëse sepse e kam parë edhe marrëveshjen që është bërë, mirëpo është mirë që këto t'i shikoni edhe një herë sepse në bazë të përgjigjes që e kam marr mundem me proceduar më tutje.

Sevdi Dernjani thekson:- çështja se pse nuk ftohet deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje në manifestime të ndryshme nuk është e vërtetë sepse personalisht ftesën ja kam dërguar unë dhe përgjigje më ka kthyer që nuk mundem me marr pjesë për arsye të ndryshme.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket përgjigjes së stomatologut i kam sqaruar gjërat që i kemi realizuar por kjo është një marrëveshje si lloj donacioni ma konkretisht nuk e di se çfarë shkelje është por ka qenë një sektor që ka munguar dhe ka qenë më se i nevojshëm për shkak se jemi duke i parë vizitat të cilat janë për stomatologë .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:59.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

